

# SISTEMIMI NË SHKOLLË DHUNA NË SHKOLLË PRINDËRIT U NDIHMOJNË FËMIJËVE TË RUHEN, TË JENË TË LUMTUR DHE TË MËSOJNË



## HYRJE

Fillimi i shkollës fillore do të duhej të ishte një përjetim i gëzueshëm dhe me vlerë, mirëpo për disa fëmijë ky ngulfatet nga dhuna në shkollë. Dhuna në shkollë mund të ketë ndikim shumë negativ në punën, shëndetin, vetëvendosjen dhe vetëbesimin e fëmijëve. Fëmijët me nevoja ose të meta të posaçme janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj dhunës.

## JINI SYÇELË

Prindërit dhe anëtarët e familjes janë shpesh të parët që i vërejnë shenjat e ushtrimit të dhunës ndaj fëmijës së tyre. Kushtojini vëmendje rrobave të shqyera, prerjeve dhe lëndimeve trupore, tekave të këqija, largimit nga shokët, agresivitetit ndaj vëllezërve dhe motrave, dhe mosdëshirës për të shkuar në shkollë.

## ÇKA ËSHTË DHUNA NË SHKOLLË?

Dhuna në shkollë mund të marrë shumë forma, nga ngacmimet e deri tek kërcënimet dhe dhuna fizike. E çfarëdo lloji që të jetë ajo, dhuna në shkollë mund ta tmerrojë një fëmijë dhe t'i shqetësojë prindërit dhe kujdestarët.

## ÇKA MUND TË BËNI?

**1. Bisedoni me fëmijën tuaj lidhur me shkollën, çka i pëlqen e çka i pengon, si dhe kush janë shokët e tij/saj. Mos e detyroni fëmijën tuaj që të bisedojë me ju, mirëpo thjesht sigurojeni atë që mund t'ju besojë dhe që qëllimi juaj është që t'i ndihmoni për t'i zgjidhur problemet, çfarëdo qofshin ato. Kujtojuani fëmijëve tuaj që ata nuk kanë bërë asgjë të keqe. Nxitini ata që të bisedojnë me ndonjë të rritur, të cilit/ës i besojnë.**

**2. Mbani shënime lidhur me gjithçka që keni zbuluar, dhe nxiteni fëmijën tuaj që të flasë gjithmonë me ju.**

**3. Kontaktoni me shkollën posa ta fitoni përshtypjen që ekziston ndonjë problem. Shkolla do të ketë po aq vullnet e dëshirë sa edhe ju për ta tejkaluar këtë situatë.**

- Bisedoni me kujdestarin e klasës, dhe mos harroni që nuk është faji i shkollës. Duke e vështruar situatën së bashku me mësuesin dhe duke e vëzhguar kontaktin mes fëmijës tuaj dhe atij/asaj që ushtron dhunë ndaj fëmijës tuaj, situata mund të tejkalohet shumë më lehtë.
- Nxiteni fëmijën tuaj që ta zgjerojë rrethin e shokëve të vet, dhe që të kërkojnë nga njëri-tjetri që të kujdesen për njëri-tjetrin.
- Nëse dhuna në shkollë vazhdon, kontaktoni përsëri me shkollën dhe shkruajini mësuesit kujdestar, në mënyrë që të mësoni më shumë se si trajtohet problemi i dhunës në shkollë nga ana e shkollës. Në këtë mënyrë ju mund ta kuptoni saktësisht se çka është duke u bërë për t'iu qasur kësaj situatë. Vazhdoni që të mbani shënime në lidhje me gjithçka që po ndodh.

**4. Bëjani të qartë fëmijës tuaj që me injorimin e situatës kjo jo vetëm që nuk tejkalohet, mirëpo faktikisht mund të bëhet edhe më e vështirë. Fëmijët duhet që të fitojnë bindjen se nuk është faji i tyre dhe që askush nuk e meriton që të ngacmohet. Mos i nxitni ata që të**

hakmerren: kjo vetëm mund të shkaktojë më shumë probleme dhe mund t'i lëndojë ata edhe më shumë.

**5. Kujt mund t'i drejtoheni?** Nëse nuk jeni të kënaqur me mënyrën e trajtimit të situatës nga ana e shkollës, ju mund të kontaktoni me Zyrën Lokale për Edukim [Local Education Authority] dhe me drejtorin e shkollës.

Nëse shqetësimi kalon në dhunë fizike, ju mund të kontaktoni me policinë. Policia nuk mund të ndërmarë asgjë kundër fëmijëve të moshës nën 10 vjeç, mirëpo tipave problematikë mund t'ua numërojnë bëmat e veta përpara prindërve të tyre.

### **Ndiqu rrugët e drejta dhe mos i merrni çështjet në duart tuaja.**

Është shumë më mirë që të mos përballemi me tipat problematikë ose me prindërit e tyre. Kjo mund të shpjerë në ngatërresa serioze dhe probleme të tjera për ju dhe fëmijën tuaj.

### **Mos lejoni që fëmija juaj të mungojë në shkollë**

Pa marrë parasysh se sa i mërzhitur është fëmija juaj, nuk mundeni assesi ta lejoni që të rrijë në shtëpi. Prindërit mund të paditen nëse nuk e çojnë fëmijën e tyre në shkollë. Gjëja më e mirë që mund të bëni, është që ta siguron fëmijën tuaj që kjo situatë do të tejkalohet dhe që ai/ajo nuk ka bërë asgjë të keqe.

## **KUR FËMIJA JUAJ I SHQETËSON TË TJERËT**

Ashtu siç jeni syçelë ndaj shenjave që fëmija juaj është viktimë, ashtu duhet që të jeni të vetëdijshëm edhe ndaj shenjave që flasin se fëmija juaj po i shqetëson të tjerët. Fëmija juaj mund t'i imitojë sjelljet agresive dhe nuk i sheh ato si të gabueshme, ose kjo mund të jetë një mënyrë e shprehjes së ndjenjave kur është duke kaluar nëpër një fazë të vështirë.

- Bisedoni me djalin ose vajzën tuaj në lidhje me arsyet e sjelljeve të tyre në këtë mënyrë, mundohuni që t'ia bëni atij ose asaj të kuptueshëm efektin rrënues që kanë sjelljet e tyre tek të tjerët.
- Kujdesuni që në familjen tuaj të mos të arrihen qëllimet nga askush me agresivitet ose me forcë, dhe tregojini fëmijës tuaj se si mund t'i bashkëngjitet të tjerëve pa pasur nevojë për dhunë.
- Diskutojeni situatën me kujdestarin e klasës së fëmijës tuaj për të parë se si mund të bashkëpunoni me shkollën për t'i dhënë fund dhunës.
- Kujdesuni që fëmija juaj ta dijë se ai/ajo duhet të përkrahet edhe nga të tjerët dhe mos i kurseni lëvdatat kur ai ose ajo tregohet i/e mirë ndaj të tjerëve.
- Bisedoni rregullisht në lidhje me situatën për t'u siguruar se nuk fshihen probleme serioze mbrapa kësaj faze trazirash.

### **Për informata dhe këshilla të mëtejme:**

**Advisory Centre for Education** Këshilla në telefon për prindër për të gjitha çështjet lidhur me shkollën.

1c Aberdeen Studios, 22 Highbury Grove, London N5 2DQ

Telefoni për ndihmë: 0207 354 8321 (E hënë – E premte, ora 2 - 5 pasdite)

**Anti Bullying Campaign** Këshilla në telefon për prindër dhe fëmijë.

185 Tower Bridge Road, London SE1 2UF

Tel: 0207 378 1446 (ora 9.30 paradite - 5.00 pasdite)

**Children's Legal Centre** Publikime dhe këshillime falas në telefon për çështje ligjore  
Tel: 01206 873 820 (E hënë – E premte, ora 10 paradite - 12.30 pasdite dhe 2 pasdite - 4.30 pasdite)

**Kidscape** Vë në dispozicion një radhë të gjerë publikimesh për të rinj, prindër dhe mësues.  
2 Grosvenor Gardens, London SW1W 0DH. Këshilltari në rastet e dhunës në shkollë është në dispozicion nga e hëna deri të premten, prej orës 10 para dite deri në orën 4 pasdite  
Tel: 0207 730 3300 Faks: 0207 730 7081

**Parentline Plus**

520 Highgate Studios, 53-79 Highgate Road, Kentish Town, London NW5 1TL

Tel: 0808 800 2222 (24 orë)

**Telefonat kujdestarë:**

NSPCC – 0808 800 5000 [www.nspcc.org.uk](http://www.nspcc.org.uk)

Childline – 0800 1111 [www.childline.org](http://www.childline.org)

**Website të tjera:**

Instituti për familje dhe prindër – [www.e-parents.org](http://www.e-parents.org)

Këshilla për luftën kundër dhunës në shkollë – [www.bullying.co.uk](http://www.bullying.co.uk)

Udhëzime të qeverisë – [www.dfes.gov.uk/bullying](http://www.dfes.gov.uk/bullying)

*Ju lutemi shënojinë në vazhdim njoftimet lokale dhe mundësitë e kontaktimit*

Të gjitha të drejtat e rezervuara © Crown, gusht 2006.